



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3430/2 Prot.

Tiranë, më 24.10.2020

Lënda: Përcillet kërkesa nr. 3620 prot, datë 21.10.2020 që Presidenti i Republikës i ka drejtuar Komisionit të Venecias.

Drejtuar: KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Tiranë

Në vijim të shkresës sonë nr. 3430/1 Prot., datë 23.10.2020, përmes së cilës ju kemi përcjellë Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11797, datë 22.10.2020, "Për kthimin në Kuvend për rishqyrtim të ligjit nr. 118/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", ju përcjellim zyrtarisht për njohje e dijeni kërkesën e Presidentit të Republikës nr. 3620 prot., datë 21.10.2020, drejtuar Komisionit Europian për Demokraci përmes Ligjit pranë Këshillit të Europës (Komisionit të Venecias) për marrjen e një Opinioni urgjent mbi procesin e ndryshimit të njëanshëm dhe të përshpejtuar të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Siç dhe jeni në dijeni, kjo kërkesë është bërë publike në median e shkruar, elektronike dhe audiovizive, ndërkohë që për lehtësi konsultimi këtë kërkesë dhe pyetjet e parashtruara nga Kreu i Shtetit për Komisionin e Venecias mund t'i gjeni të publikuara në të dy gjuhët (angleze dhe shqipe) në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës në [link-un vijues: https://president.al/kerkesa-e-presidentit-te-republikes-sh-t-z-ilir-meta-drejtuar-komisionit-te-venecias-per-nje-opinion-urgjent-mbi-procesin-e-ndryshimit-te-njeanshem-dhe-te-pershpejtuar-te-kushtetutes-dhe-kodit-zgjedh/](https://president.al/kerkesa-e-presidentit-te-republikes-sh-t-z-ilir-meta-drejtuar-komisionit-te-venecias-per-nje-opinion-urgjent-mbi-procesin-e-ndryshimit-te-njeanshem-dhe-te-pershpejtuar-te-kushtetutes-dhe-kodit-zgjedh/)

Gjejmë rastin të përsërisim edhe një here thirrjen e Presidentit të Republikës se, tashmë pas kthimit në Kuvend të ligjit nr. 118/2020, Kuvendi i Shqipërisë (duke filluar që nga komisionet përgjegjëse parlamentare) duhet ta rishqyrtojë këtë nismë nën dritën e arsytimit të Dekretit nr. 11797, datë 22.10.2020, dhe të rekomandimeve të pritshme të Komisionit të Venecias, i cili është investuar tashmë nga Presidenti i Republikës mbi këto çështje.

Bashkëlidhur kopje në gjuhën angleze dhe shqipe të kërkesës së Presidentit të Republikës nr. 3620 prot, datë 21.10.2020, drejtuar Komisionit të Venecias.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela Zonja